

Nr. Prot

Tiranë, më _____.____. 2025

Lutemi referoni këtë numër në përgjigje

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT, NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT

Drejtuar: Bashkimit të operatorëve ekonomik “A & E” sh.p.k, NIPT K49322502N (80 %) me adresë: Lagja “Mustafa Matohiti”, rruga Baba Abaz, zona kadastrale 3574, Nr. pasurisë 4384, pallati 24, Tepelenë Gjirokastrë & “NOVAMAT” sh.p.k, NIPT K81615002O (20 %) me adresë: Rruga “Ismail Qemali”, Pallati Samos Tower, kt.8, Nr 41, Njësia Nr.05 , Tiranë.

Tipi i Kontratës: Punë.

Lloji i Procedurës së prokurimit: E hapur me mjete elektronike.

Numri i referencës së procedurës /Lotit: NR.REF - 52473-06-26-2025.

Objekti i kontratës: “Rinovimi i impiantit shpërndarës 10kV në HEC Vau i Dejës që përfshin rikonfigurimin e skemës me dy seksione për të ruajtur redundancën, instalimi i 2(dy) TR 10/0.4kV dhe punime ndërtimore për krijimin e hapësirave”.

Kohëzgjatja e kontratës: 15 (Pesëmbëdhjetë) muaj.

🔧 Për realizimin e inspektimit dhe hartimin e projektit afati do të jetë 3 muaj nga data e lidhjes së kontratës.

🔧 Pas përfundimit të procesit të hartimit dhe pranimit të projektit të zbatimit dhe miratimet përkatëse të lejeve, kontraktori ka afat maksimal 12 muaj për realizimin e punimeve përkatëse.

Data e Publikimit në SPE, të Njoftimit të Fituesit nga i cili nisin afatet e ankimit: 06.08.2025.

Data e Publikimit në Buletin e Njoftimeve Publike, të Njoftimit të Fituesit nga i cili nisin afatet e ankimit: Buletini Nr.42 datë 11 Gusht 2025.

KRITERET E PËRZGJEDHJES SË FITUESIT:

- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto ☐
- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim X

Me anë të këtij Formulari ju informojmë se, në këtë procedurë/lot kanë marrë pjesë, Ofertuesit si mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

- 1) Operatori ekonomik “HTM” sh.p.k, NIPT K97006004D, me vlerë oferte 125,560,500 (Njëqind e njëzetë e pesë milion e pesëqind e gjashtëdhjetë mijë e pesëqind) Lekë pa TVSH.
- 2) Bashkimi i operatorëve ekonomik “A & E” sh.p.k, NIPT K49322502N (80 %) & “NOVAMAT” sh.p.k, NIPT K81615002O (20 %), me vlerë oferte 143,000,000 (Njëqind e dyzetë e tre milion) Lekë pa TVSH.
- 3) Operatori ekonomik “G.P.G. COMPANY” sh.p.k, NIPTJ64324443V, me vlerë oferte 147,000,000 (Njëqind e dyzetë e shtatë milion) Lekë pa TVSH.
- 4) Operatori ekonomik “DIVITECH” sh.p.k, NIPT L01306049O, me vlerë oferte 149,000,000 (Njëqind e dyzetë e nëntë milion) Lekë pa TVSH.
- 5) Bashkimi i operatorëve ekonomik “Eidon-Grup” sh.p.k, NIPT L91323019S (2.19%) & “JUNIK”sh.p.k, NIPT J68007522L (97.81%), me vlerë oferte 149,069,000 (Njëqind e dyzetë e nëntë milion e gjashtëdhjetë e nëntë mijë) Lekë pa TVSH.

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

- 1) Operatori ekonomik “HTM” sh.p.k, NIPT K97006004D, me vlerë oferte 125,560,500 (Njëqind e njëzetë e pesë milion e pesëqind e gjashtëdhjetë mijë e pesëqind) Lekë pa TVSH.

Operatori ekonomik “HTM” sh.p.k, nuk plotëson kriterin për kualifikim 2.3.8 pasi për:

✚ Zërin Rele të mbrojtjes sipas specifikimeve teknike, nuk është paraqitur dëshmi të testimeve zyrtare të lëshuara nga institucione të autorizuar me ligj ose nga prodhuesi, të kryera më parë. Dëshmi të cilat vërtetojnë pajtueshmërinë e materialeve të prodhuara me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara, kërkesa të këtij kriteri.

✚ Zërin RTU sipas specifikimeve teknike, nuk është paraqitur dëshmi të testimeve zyrtare të lëshuara nga institucione të autorizuar me ligj ose nga prodhuesi, të kryera më parë. Dëshmi të cilat vërtetojnë pajtueshmërinë e materialeve të prodhuara me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara, kërkesë e këtij kriteri.

Në lidhje me kriterin teknik, pika 2.3.8, u bë vlerësimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE) nga Operatori Ekonomik “HTM” sh.p.k. Në lidhje me këtë kriter, u pranua dokumentacioni teknik i dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE) nga Operatori Ekonomik, në lidhje me katalogun e zërit Reletë e mbrojtjes sipas specifikimeve teknike, ndërsa në lidhje me kërkesën e kriterit 2.3.8 mbi ***Dëshmi të testimeve zyrtare të lëshuara nga institucione të autorizuar me ligj ose nga prodhuesi, të kryera më parë. Dëshmitë duhet të vërtetojnë pajtueshmërinë e materialeve të prodhuara (lista e mësipërme ose të ngjashme) me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara***, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave vlerëson se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik

ankimues në këtë procedurë prokurimi, nuk mund të konsiderohet i plotë dhe i vlefshëm për sa kohë që nuk provohet në këtë dokument, të jenë paraqitur, raportet e testimeve zyrtare për reletë e mbrojtjes dhe RTU. Ndërkohë sipas kriterit 2.3.8, kërkohet qartazi që të paraqiten testimet zyrtare tip edhe për reletë e mbrojtjes dhe RTU.

Për sa është paraqitur nga OE në materialin e 2.3.8 – katalogë e test raporte, vlerësohet se janë paraqitur vetëm test raporte për zërat:

🚧 **Çela 10kV sipas specifikimeve teknike.**

🚧 **Kablo TM dhe TU sipas specifikimeve teknike.**

Në zbatim të Ligjit Nr. 162 datë 26/06/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar dhe VKM Nr. 285, datë 19/05/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, kriteret për kualifikim, vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

🚧 Operatori ekonomik “HTM” sh.p.k, nuk plotëson kriterin për kualifikim 2.3.9, pasi nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion për plotësimin e këtij kriteri, në të cilin kërkohet që OE duhet të paraqesë Autorizim prodhuesi ose distributori të autorizuar për shërbimin e integritetit scada të HEC Vau i Dejës të sinjaleve të impiantit të ri 10kV.

Në lidhje me kriterin teknik, pika 2.3.9, u bë vlerësimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE) nga Operatori Ekonomik. Referuar dokumentacionit të ngarkuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE) nga Operatori Ekonomik, “HTM” sh.p.k, NIPT K97006004D, nga KVO u konstatua se është paraqitur dokumentacioni me subjektin *Letër Autorizim*, ku deklarohet shprehimisht se:

SCHNEIDER ELECTRIC BULGARIA EOOD Autorizon Kompaninë “HTM” sh.p.k me përfaqësues ligjor, të paraqesë një ofertë dhe më pas të negociojë dhe nënshkruaj një kontratë me ju kundrejt kontratës së prokurimit: “Rinovimi i impiantit të shpërndarjes 10kV në HEC-in e Vaut të Dejës, i cili përfshin rikonfigurimin e skemës me dy seksione për të ruajtur redundancën, instalimin e 2 (dy) TR 10/0.4 kV dhe punimet e ndërtimit për të krijuar hapësira”. Me anë të kësaj, ne zgjerojmë garancinë dhe garancinë tonë të plotë sipas garancisë së prodhuesit për mallrat e ofruara për furnizim nga firma e mësipërme dhe të prodhuara nga SCHNEIDER ELECTRIC, në lidhje me këtë ftesë për ofertë: “Rinovimi i impiantit të shpërndarjes 10kV në HEC-in e Vaut të Dejës, i cili përfshin rikonfigurimin e skemës me dy seksione për të ruajtur redundancën, instalimin e 2 (dy) TR 10/0.4 kV dhe punimet e ndërtimit për të krijuar hapësira”/ REF- 52473-06-26-2025.

Në autorizimin e paraqitur nga Schneider, jo vetëm që nuk është marrë autorizimi nga prodhuesi i sistemit ekzistues por jepet autorizimi specifikisht vetëm për mallrat që ofertohen dhe jo për shërbimet.

Në dokumentet e paraqitura nuk jepet asnjë e dhënë mbi autorizimin nga prodhuesi i sistemit ekzistues të SCADA Symphony Plus të HEC Vau i Dejës. Schneider nuk është prodhuesi i këtij sistemi dhe nuk është paraqitur asnjë dokument që të vërtetojë lidhjen me prodhuesin e SCADA të HEC Vau i Dejës.

Për më tepër, referuar dokumenteve të paraqitura në seksionin D Kufizime të furnizimit (Part D Limit of supply), specifikisht në faqën 21 (Comments in the offer), pika 12, Schneider shprehet qartë se Sistemi SCADA është jashtë fushë veprimit të tij në lidhje me këtë oferte (SCADA system is out of scope).

Në zbatim të Ligjit Nr. 162 datë 26/06/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar dhe VKM Nr. 285, datë 19/05/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, kriteret për kualifikim, vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

Rivlerësimi mbi ofertën e operatorit ekonomik HTM sh.p.k, në zbatim të vendimit 1213/2025 të KPP.

2) Operatori ekonomik “G.P.G. COMPANY” sh.p.k, NIPTJ64324443V, pasi:

✚ Në Shtojcën 2 - lista e çmimeve sipas zërave të preventivit, operatori ekonomik nuk ka ofertuar referuar dokumentacionit të ngarkuar në SPE, bashkëlidhur DST-ve, por vetëm në një zë të vetëm: Projektim + zbatim punimesh.

✚ OE nuk plotëson kriterin teknik pika 2.3.5, pasi në pikën B - Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme sipas shtojcës 8- Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit ka deklaruar se: Inxhinieri i Telekomunikacionit, ka lidhur kontratë punësimi me shoqërinë me objekt punësimi për tenderin “Rinovimi i impiantit shpërndarës 10kV në HEC Vau i Dejës që përfshin rikonfigurimin e skemës me dy seksione për të ruajtur redundancën, instalimi i 2(dy) TR 10/0.4kV dhe punime ndërtimore për krijimin e hapësirave”. Referuar kriterit teknik, pika 2.3.5 është kërkuar: Operatori Ekonomik duhet të ketë në stafin e tij minimalisht 1 (një) Inxhinier elektronik ose telekomunikacion, ku dhe periudha e Listëpagesave të shoqërisë formulari E-sig, **është kërkuar Prill 2025 - Qershor 2025**. Pra në këtë kriter është kërkuar që Ing elektronik ose telekomunikacioni të jetë në stafin e operatorit ekonomik dhe jo me kontratë pune të vlefshme ose kontratë bashkëpunimi të vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi si në rastin e deklaruar.

✚ OE nuk plotëson kriterin për kualifikim 2.3.6 pasi sipas formularit të vetëdeklarimit në pikën B - Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme, operatori ekonomik ka deklaruar se disponon 4 punonjës me profesion elektrikist të certifikuar në sigurimin teknike

nga të cilët 3 (tre) në kategorinë II dhe 1 (një) në kategorinë IV në kundërshtim me kërkesën për kualifikim ku kërkohet që operatori ekonomik të ketë në stafin e tij minimalisht 3 (tre) punonjës të çertifikuar me kategorinë e sigurimit teknik, nga të cilët minimalisht 2 (dy) punonjës të jenë të çertifikuar me kategorinë e sigurimit teknik Grupi IV-V.

✚ OE nuk plotëson kriterin për kualifikim 2.3.9, pasi për plotësimin e këtij kriteri operatori ekonomik ka paraqitur autorizim distributori por nuk është paraqitur asnjë dokumentacion i cili të vërtetojë lidhjen midis distributorit të autorizuar dhe prodhuesit, kërkesë e këtij kriteri.

3) Operatori ekonomik “DIVITECH” sh.p.k, NIPT L01306049O, pasi:

✚ Nuk ka paraqitur Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

✚ Nuk ka paraqitur ofertën sipas formatit të caktuar në DT, Shtojca 2- lista e çmimeve sipas zërave të preventivit;

✚ Nuk plotëson kriterin teknik pika 2.3.2, pasi nuk ka paraqitur licencën profesionale të shoqërisë sipas kërkesave dhe kategorive të kërkuara për këtë procedurë prokurimi;

✚ Nuk plotëson kriterin teknik pika 2.3.3, pasi nuk ka deklaruar 1 (një) inxhinier ndërtimi në pikën B - Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme sipas shtojcës 8 - Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit;

✚ Nuk plotëson kriterin teknik pika 2.3.4, pasi nuk ka deklaruar të ketë në stafin e tij ose me kontratë bashkëpunimi minimalisht 1 (një) inxhinier topograf/gjeodet, në pikën B - Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme sipas shtojcës 8 - Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit;

✚ Nuk plotëson kriterin teknik pika 2.3.8, pasi nuk paraqitur të plotësuar kolonën me të dhënat teknike të ofertuar në të gjitha tabelat e paraqitura sipas Specifikimeve teknike dhe Termave të Referencës si dhe nuk ka paraqitur për këtë pikë:

✚ *Autorizim nga Prodhuesi ose Distributor i Autorizuar. Dokumentacioni duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, e-mail, website, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij. Në rast se do të paraqitet autorizim nga distributori i autorizuar nga prodhuesi duhet të vërtetohet lidhja midis distributorit të autorizuar dhe prodhuesit.*

✚ *Dëshmi të testimeve zyrtare të lëshuara nga institucione të autorizuar me ligj ose nga prodhuesi, të kryera më parë. Dëshmitë duhet të vërtetojnë pajtueshmërinë e materialeve të prodhuara (lista e mësipërme ose të ngjashme) me specifikimet teknike dhe standardet e kërkuara.*

✚ Nuk plotëson kriterin teknik pika 2.3.9, pasi nuk ka paraqitur Autorizim nga Prodhuesi ose Distributor i Autorizuar për shërbimin e integritetit në SCADA të HEC Vau Dejës të sinjaleve të impianit të ri 10kV.

✚ Nuk plotëson kriterin teknik pika 2.3.10, pasi nuk ka deklaruar asnjë nga mjetet dhe pajisjet e kërkuara, në pikën B - Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme sipas shtojcës 8- Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit.

4) Bashkimi i operatorëve ekonomik “Eidon-Grup” sh.p.k, NIPT L91323019S (2.19%) & “JUNIK”sh.p.k, NIPT J68007522L (97.81%), pasi:

✚ Bashkimi i operatorëve ekonomik nuk plotëson kriterin për kualifikim 2.2.2, pasi operatori ekonomik “Eidon – Grup” sh.p.k, anëtar i këtij bashkimi nuk ka paraqitur bilancet e 3 viteve të fundit kërkesë e këtij kriteri;

✚ Bashkimi i operatorëve ekonomik nuk plotëson kriterin për kualifikim 2.3.6 pasi sipas formularëve të vetëdeklarimit të paraqitur nga anëtarët e këtij bashkimi numri total i punonjësve të deklaruar për plotësimin e këtij kriteri është 2 (dy) nga 3 (tre) të kërkuar;

✚ Bashkimi i operatorëve ekonomik nuk plotëson kriterin për kualifikim 2.3.8 pasi nuk ka paraqitur një dokumentacion për plotësimin e këtij kriteri;

✚ Bashkimi i operatorëve ekonomik nuk plotëson kriterin për kualifikim 2.3.9 pasi nuk ka paraqitur një dokumentacion për plotësimin e këtij kriteri;

✚ Bashkimi i operatorëve ekonomik nuk plotëson kriterin për kualifikim 2.3.10 pasi sipas formularëve të vetëdeklarimit të paraqitur nga anëtarët e këtij bashkimi kanë deklaruar disponimin e vetëm 2 (dy) mjeteve dhe pajisjeve nga 4 (katër) të kërkuar në këtë kriter.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Bashkimin e operatorëve ekonomik “A & E” sh.p.k, NIPT K49322502N (80 %) me adresë: Lagja “Mustafa Matohiti”, rruga Baba Abaz, zona kadastrale 3574, Nr. pasurisë 4384, pallati 24, Tepelenë Gjirokastrë & “NOVAMAT” sh.p.k, NIPT K81615002O (20 %) me adresë: Rruga “Ismail Qemali”, Pallati Samos Tower, kt.8, Nr 41, Njësia Nr.05, Tiranë se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 143,000,000 (Njëqind e dyzetë e tre milion) Lekë pa TVSH, është identifikuar si ofertues i suksesshëm.

Rrjedhimisht jeni i lutur të paraqisni pranë Autoritetit Kontraktor KESH sh.a, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet siguri i ofertës suaj siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit, nga i cili nisin afatet e ankimit /Njoftimit të Anulimit, nga i cili nisin afatet e ankimit.

PO ☒

JO ☐

Nëse Po:

Vendim Nr.1213/2025, datë 10.09.2025, i Komisionit të Prokurimit Publik, për rivlerësimin e ofertës së operatorit ekonomik HTM sh.p.k.

Vendim Nr.1261/2025, datë 16.09.2025, i Komisionit të Prokurimit Publik, lejimin për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Erald Elezi